

## Akt Themelimi

I shoqerise tregtare **"BRUDAS"** SH.P.K

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512

Date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtariseprivate dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregatre" dhe te ligjitNr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhet respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket :

Individ me pergjegjesi te kufizuar, banues ne Tirane , krijoje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **"BRUDAS"** SH.P.K me akt themelimi si vijon :

### Neni 1

#### Formulimi

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur **"BRUDAS"** SH.P.K. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te keteseline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

### Neni 2

#### Selia e Shoqerise

Selia e shoqerise tregtare private **"BRUDAS"** SH.P.K do te kete seline ne Rr."Tele Ndini ,Pallati Nr .1 kati 1" Njesia Bashkiake Nr.3 Tirane .

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoje filiale si Brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese.

### Neni 3

#### Objektivi i Veprimtarise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e :

Tregtimi me shumice e pakice, import-eksport i mallrave te ndryshme'

1. Import Export, shitje me shumice dhe pakice e mjeteve te transportit te kapaciteteve te

import, shitja me shumice dhe pakice e mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire, te kapaciteteve te ndryshme, me ose pa rimorkio, makineri pajisje industriale. Eksport-import, shitja me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te pjeseve te kembimit, gomave te automjeteve dhe te mjeteve bujqesore, baterive. Hapje dhe shfrytezim i serviseve per riparimin dhe mirembajtjen e te gjitha llojeve te mjeteve, hapja pika lavazhi. Investime dhe sherbime ne fushen e pasurive te paluajtshme, duke perfshire pa u kufizuar, shitje, qiradhenie, riparime, blerje, rimarrje te pasurive te patundshme ne shqiperi. Kontrolli teknik dhe periodik i automjeteve te kapaciteteve te ndryshme qe perdoren per transportin e pasagjereve ose te mallrave, te mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire. Shitja me pakice e lendeve djegese (nafte, benzine, lubrifikante, etj). Administrimi i pikave te karburantit per shitje me pakice ne territorin shqiptar. Transporti i lendeve djegese brenda dhe jashte vendit me mjetet e shoqerise ose te treteve. Hapja administrimi i pikave te karburantit dhe te mini-dyqaneve per tregtimin e aksesoreve te te gjitha llojeve te automjeteve. Aktivitet ne fushen e turizmit, hotelrise, bar, restorant, internet-kafe. Import-eksport i mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore dhe perdorim shtepiak si : detergjente, tregtim i te gjitha materialeve, veshmbathje, tuba rekordi, elektropompa dhe mirembajtja e tyre. etj. me shumice dhe pakice, te artikujve kancelarie te te gjitha llojeve, pajisje kompjuterike te te gjitha llojeve. Tregtim pajisje elektrike dhe elektronike si dhe sherbimin per to, prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit, ndertimin e objekteve me karakter social e publik, investime ne fushen e ndertimit etj. Zbatime punimesh ndertimi, konsulence, supervision dhe kolaudim punimesh. Tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha produkteve bujqesore, punime te ndryshme ne bujqesi (mbjellje , korrje , shirje etj.), transport i produkteve bujqesore.

2. Shpime me sonde, import-eksport, makineri e pajisje transporti , pjese kembimi per makineri dhe pajisje te ndryshme, mallra dhe pajisje elektrike, elektro-shtepiake te te gjitha llojeve, tregti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial etj. Internet caffe, Bar – Restorant, Hoteleri Turizem etj.

3. Ne fushen e prodhimeve te ndertimit:

- Prodhim dhe tregtime te materialeve, prodhim dhe tregtimi I betoneve te ndryshme , parafabrikate dhe elemente te ndertimit, prodhimin e elementeve gjysem fabrikat, prodhim dhe tregtim I dyerve dhe dritareve prej druri dhe duralumini, te drejten e franksionimeve te zhavorreve etj, Veprimtari me fushen e ndertimit si ndertime civile, ndertime industrial, turistike, bujqesore etj. Veprimtari ne fushen e turizmit, transportit, industrise, ne perpunimin e tregtimin e lendeve djegese etj.
- Shoqeria, brenda cazeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Shoqeria mund te hape veprimtari te reja, te krijojte sipermarrje te reja ose te marre pjese ne sipermarrje te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit pa cenuar objektin kryesore te shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

#### **Neni 4**

##### **Kohezgjatja e Shoqerise**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te papercaktuar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe percfaredo lloj shkakut .

#### **Neni 5**

##### **Kapitali i Shoqerise**

Kapitali fillestar i shoqerise private "BRUDAS" SH.P.K do te jete 1.000.000 (nje million ) leke I ndare ne kuota si me poshte:

- Ervis Mamica 100 % ( njeqind perqind ) te kuotave

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet.

#### **Neni 6**

##### **Drejtimi i Shoqerise**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj i cili zgjidhet ne perputhje me Statutin e Shoqerise. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marrredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota nedrejtimin e saj .

Administratori zgjidhet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte ripertesitje, me perjashtim te doreheqjes ose te shkrakimit per paaftesi.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me autorizim te Shoqerise.

#### **Neni 7**

##### **Te ardhurat**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakëve ne perpjesetim me kuotat qe zoterojne.

#### **Neni 8**

Ortakët themelues kane te drejte te emerojne dhe administratore te tjere te vlerave material.

Kane te drejte te caktojne financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjeresi ortakë.

#### **Neni 9**



## **Konfliktet**

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.

### **Neni 10**

#### **Vula**

Shoqeria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

### **Neni 11**

Shoqeria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

### **Neni 12**

Akti i themelimit u përpilua në 3 ( tre ) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "BRUDAS" SH.P.K

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

**Ortakët themelues**

**"BRUDAS" SH.P.K**

**Ervis Mamica**

*Ervis Mamica*  
